



Shkolla e Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare ne

Boston

JANAR 2007

MASSACHUSETTS ALBANIAN AMERICAN SOCIETY

Ky eshte nje botim i Keshillit Drejtues te Shkolles se Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare ne Boston.

Shkolla eshte hapur dhe administrohet nen kujdesin e Shoqates se Shqiptaro - Amerikaneve ne Massachusetts dhe mbeshtetet nga individe dhe institucione ne SHBA dhe Shqiperi.

NE KETE NUMER

Hapja e 1
shkolles

Semetri I - 1
Pranvere
2006

Semestri II 2
Vjeshte 2006

Semestri III 2
Pranvere
2007

Informacion 2

Nga hapja e Shkolles se Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare nje vit me pare

23 mars 2006

"Kur zhduket nje gjuhe vdes bashke me te edhe nje menyre e te parit dhe te interpretuarit te botes". Keto qene nder te tjera fjalet e linguistes Enkelejda Kapia ne ceremonine e hapjes se Shkolles se Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare ne Boston. Ne mjediset e Universitetit te Bostonit ku u zhvillua ceremonia te shtunen paradite u mblodhen shqiptare e shqiptaro-amerikane te te gjitha moshave e prirjeve; nxenes te ardhshem e prinder, gjysher, studente, veprimtare te komunitetit, mesues e artiste. Fjalen e hapjes e tha zv.presidenti i Klubit Shqiptar te Studenteve ne BU Nick Nikaj ndjekur nga Albana Orgocka, bashkekryetare e Shoqates Shqiptaro-Amerikane te Masacusetsit, organizem i cili

ofroi idene dhe e materializoi ate pas nje sere perpjekjesh te nje grupi individesh te mbledhur rreth saj. Shkolla do ofroje gjashte klasa gjithsej; tre prej tyre do mbahen ne mjediset e Universitetit te Bostonit, dy te tjera ne Katedralen e Shen Gjergjit dhe e



Foto nga hapja e shkolles ne Universitetin e Bostonit, 23 Mars 2006

fundit ne Kishen e Shen Trinise. Mesuesit do jene profesioniste te

diplomuar ne universitetet shqiptare. Numri i studenteve te regjistruar arrin ne 51, me nje gjeografi moshe qe fillon me 6 - vjecare e perfundon me te rritur. Oret e mesimit do bazohen ne nje plan pune huazuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences e Shqiperise

Falenderime speciale shkuan per Universitetin e Bostonit, Katedralen e Shen Gjergjit, Kishen e Shen Trinise, Qeverise se Shqiperise, Ministrin e Arsimit te Shqiperise Genc Pollo dhe institucionin qe ai drejton, i cili mundesoi librat e nevojshem.

Alfred Lela, Boston

Mbyllet semestri i pare i shkolles 18 qershor 2006

Ne 18 qershor 2006 u organizua ceremonia e mbylljes se semestrit te pranveres 2006 te Shkolles se Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare,

Ceremonia, e cila u planifikua te perkonte me festimet e dites se babait, u zhvillua ne parkun e bukur "Blue Hills Reservation" ne periferi te Bostonit. Pervec nxenesve, prinderve dhe familjeve te tyre moren pjese edhe mbeshtetes te shkolles e shume qytetare te komunitetit. Ne ceremoni, e cila u be ne nje mot te mrekullueshem, nxenesve iu shperndane diplomat e semestrit.



Me tej, programi vazhdoi me shume aktivitete interesante si recitime ne gjuhen shqipe qe nxenesit e shkolles kishin pergatitur nen kujdesin e mesueseve te pasionuara, zbavitje ne plazh ne motin e bukur e te ngrohete dhe perfundoi me nje ndeshje miqesore futbollit per te festuar

festen e babait. Me diplomat e



gjuhes shqipe ne dore, me gezim, kenaqesi e krenari u mbyll semestri i pare i shkolles se Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare ne Boston.

Semestri i Vjeshtes 2006



Ne 7 tetor 2006 filloi semestri i vjeshtes i shkolles se Gjuhes



dhe Trashegimise Shqiptare ne Boston. Ky semester u zhvillua me sukses dhe u mbyll ne daten 24 dhjetor 2006.

Shkolla e Gjuhes dhe Trashe-

gimise Shqiptare organizoi nje mbremje me rastin e mbylljes se semestrit te dyte te shkolles si dhe per te festuar festat e fundvitit. Mbremja ishte nje sukses. Femijet kishin pergatitur nje program artistik me kenge dhe vjersha per vitin e ri ne gjuhen shqipe. Nxenesve ju shperndane deftesat si dhe nga nje dhurate e vogel.

Keshilli Drejtues dhe gjithë mbeshtetesis e shkolles falenderojne nxenesit, mesueset per punen e mire qe kane

bere, prinderit qe me dedikim i



sjellin femijet ne shkolle cdo fundjave.

Mesueset: Vilka Markovich, Vilma Simeqi, Iljana Kule, Vjollca Avrami, Nikoleta Dushi
Koordinatorë: Blerina Omari

Semestri i Pranveres 2007



Ne 20 janar 2007 ka rifilluar perseri aktivitetin mesimor Shkolla e Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare ne Boston. Edhe kete semester kjo shkolle do te ofrojë abetare, lexim, shkrim, histori dhe aktivitete kulturore shqiptare me mësues profesionistë. Grup-moshat e fëmijëve numërojnë prej 6 - 15 vjeç, të cdo niveli në gjuhen shqipe apo te tjere që kanë anglishten gjuhen e tyre



amtare, gjithashtu dhe nje klase per te rriturit. Fale deshires se shume prinderve dhe nxenesve per nje periudhe me te zgjatur te zhvillimit te mesimit ne shkollen shqipe, ndryshe nga me pare, ky semester shkollor do te mbarojë ne 13 Maj 2007.

Orari dhe vendet :

- 1) Universiteti i Bostonit / 2 Sherbon St, Boston, MA / cdo te shtune / ora 10-12
- 2) Katedralja e Shen Gjergjit /

523 E Broadway, South Boston, MA /cdo te diel / ora 10-12

3) Kisha e Shen Trinise / 245 D Street, South Boston, MA / cdo te diel / ora 10-12

Për me shume informacione mund te kontaktoni koordinatorën Blerina Omari:

tel: (978) 821-8858

e-mail: shkollaboston@yahoo.com

Ju mirepresim.

Informacion

Shkolla e Gjuhes dhe Trashegimise Shqiptare drejtohet nga nje keshill i perbere nga keta anetare: Albana Orgocka—Presidente e Keshillit, Fatmir Beja, Adnan Derti, Rolanda Dhimitri, Agron Gjerasi, Stefan Kochi, Oltiana Mara, Vilka Markovich, Gentiana Pambuku.

Adresa:

Albanian Language and Heritage School

PO BOX 960346

Boston, MA 02196

Email: shkollaboston@yahoo.com